

PLANI DHE PROGRAMI OPERATIV

DEZINFEKTIM, DEZINSEKTIMI dhe DERATIZIMI PARANDALUES (si pjesë nga masat e përgjithshme për parandalimin dhe heqjen e smundjeve infektuese)

Në pajtim me nenin 3,5 dhe 11, dhe në bazë të nenit 12 paragrafi 1 pika 4 nga i njëjti nen, nenit 14 paragrafi 2 si dhe nenet 41,42,61 paragrafi 2, 63 dhe 64, paragrafi 1 pikë 3 të Ligjit për mbrojtjen e popullatës nga smundjet infektuese ("Gz. zyrtare e RM-së" nr.66/2004), dhe Aktvendimit dhe Rekomandimeve nga DSZI, dezinfektimi,dezinsektimi dhe deratizimi parandalues, është shkruar si një nga masat e përgjithshme për parandalimin dhe heqjen e smundjeve infektuese.

Përcaktimi i gjendjes dhe vlerësimi i rrezikut:

▪ Përcaktimi i gjendjes dhe rreziqeve:

- Faktorët e favorshëm klimatik biologjik dhe dimrat e butë në vitet e fundit jashtzakonisht godasin në zhvillimin e insekteve në mes të cilave edhe mushkonjave, mundëson optimum biologjik në zhvillimin e ciklit.

Dekadën e fundit e shënuan ndryshimet globale klimatike të cilat si pasojë kanë ndryshime në sjelljen dhe përhapjen e viruseve bartëse dhe smundjeve dhe me to edhe të smundjeve të transmetueshme.

Përcaktimi i vendeve kritike të kontrollit:

Përcaktimi i lokacioneve për kryerjen e trajtimit – vendbanimi i mushkonjave:

Ndarja e teritorit të Komunës së Kërçovës në disa Sektore sipas kushteve ekologjike, prezencën e njerëzve dhe të ngjajshme:

- bërthama qendrore e qytetit të Kërçovës dhe komuniteteve urbane në Dërgovë, Vraneshticë, Oslomej dhe Zajaz,
- deponija e qytetit dhe deponitë e tjera të egra
- "Kalaja e Kërçovës"
- Rripi i pyllit në veprimin "Krushinë "

- Kanale dhe ndalimit kryesor në lokacionet:
- -rr."Uzhiçka" kanali në vendin mbi stacionin hekurudhorë
- Lëvizja nga SHF "V. Polezhinoski" deri te Stacioni Veterinarë
- Lëvizja nga Tregu i Kafshëve deri te Tregu i Qytetit
- Vendi i ashtuquajtur "Gjelbërimi"– Sërbicë
- Rrjedhat e lumenjve Sushicë, Zajaz, Temnicë, Treska, Baçishtit, lumi Beliçka
- Kanali në zonën e Aranjellit
- Kanali në zonën e Llazarovcit
- -Kanali në Ivanidoll

Përcaktimi i vendeve kritike të kontrollit

- Përcaktimi i lokacioneve për kryerjen e trajtimit – deratizim:

Procesi i deratizimit do të kryhet në shkollën e mesme dhe shkollat fillore të cilat gjenden në teritorin e Komunës së Kërçovës

- Universiteti i "Tetovës"
- Universiteti "Kliment Ohridski"
- SHMK "Mirko Mileski"
- SHMK "Drita"
- SHF "Kuzman Josifoski- Pitu"
- SHF "Sande Shterjoski"
- SHF "D-r Vlladimir Polezhinoski"
- SHF "Hristo Uzunov" Dërgovë
- SHF "Milto Gura" Strelcë
- SHF "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Sërbicë
- SHF "Naim Frshëri" Jagoll Dolencë
- SHF "Faik Konica" Greshnicë
- SHF "Rexho Rushit Zajazi" Zajaz

Deratizimi do të kryhet edhe në secilën puset në Komunën e Kërçovës

Në teritorin prej 693714 km²

Në secilin sektor individualisht do të kryhet testimi i :

- **vatrave** : vende për shumimin e mushkonjave
- **lokaliteteve**: vende në të cilat mushkonjat fluturojnë në kërkim të ushqimit
- **zonave –bariere**: zonat e mbrojtura rreth vatrave dhe vendeve të banuara.

▪ **Njoftim:**

-Para secilit trajtim do të bëhet njoftimi, informimi publik në mënyrë të shkruar, përmes medimeve elektronike ose në mënyrë direkte me organet kompetente: policinë, njësin e zjarrfikësve, qendrën e shëndetit, shoqatën e bletarëve dhe të tjera, për terminin e sakët të akcionit, llojin e produktit, mënyrën e realizimit të trajtimit.

Vëzhgimi për kryerjen e Programit:

▪ **Mbikqyrje dhe kontroll të kryerjes:**

E kryejn përfaqësues të porositësit të shërbimit dhe ekipi profesional i kryerjes

▪ **Gjithsej sipërfaqja e paraparë për trajtim:**

2h800 HA.

▪ **Parametrat për zbatimin e hapësirës toksore ULV për stërpikje:**

Do të kryhet vëzhgimi dhe kontrolli i parametrave të fundit gjatë performancës së menjëhershme

- **Kushtet mikro-meteorologjike:**

-temperatura

-shpejtësia e erës

-stabiliteti i ajrit

-karakteri anasjelltas i nxehtësisë

Suksesi i Programit:

Vlerësimi i suksesit nënkupton:

-vlerësimin e efikasitetit dhe

-vlerësimin e sigurisë së trajtimit që është kryer.

Vlerësimin e jep porositësi i shërbimit dhe ekipi profesional i kryerjes.

Përgatiti:

Inxh.-bioteknolog: Emilija Petkoska

Nr. _____

Dt. _____ .2023

Kërçovë

**KËSHILLI I KOMUNËS SË KËRÇOVËS
KRYETAR,
Skender Xhabiri**
